

KONTRATË SHITBLERJE AKSIONESH

**NË LIDHJE ME SHITBLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË
FUTBOLL CLUB DINAMO CITY SH.A**

E LIDHUR NDËRMJET

Z. ADRIAN BARDHI

[në cilësinë e Shitësit]



dhe

FORTIS BETON CO. SH.P.K

[në cilësinë e Blerësit]

Orest Sota



KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH

NË DURRËS, SOT MË DATË 02.05.2024 (DY MIJË E NJËZET E KATËR),
NËNSHKRUHET KJO KONTRATË MIDIS PALËVE SI MË POSHTË, NË LIDHJE ME
SHITJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË AKSIONARE:

- “FUTBOLL CLUB DINAMO CITY” Sh.A. (“Shoqëria”) është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numrin unik të identifikimit NUIS - M12121037S, me seli në adresën Rruga “Asti Gogoli” Lagjia nr.14, Pasuria me nr.5/104, Vol.9, faqe 214, ZK.8516, Durrës, Shqipëri;

Nënshkruar midis

- **Z. Adrian Bardhi**, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më datë 24.08.1970, identifikuar me dokumentin e identifikimit pasaportë me numër BC8084591 dhe numër personal H00824167H, (në vijim “Shitësi”);

dhe

- Shoqërisë FORTIS BETON CO.SH.P.K, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numrin unik të identifikimit NUIS - L71912018R, me seli në adresën Rruga R Rruga Leke Zaharia, Ambienti me nr. Pasurie 346/15, 346/28, 346/30, 346/32, ZK.3321, Sharre, Vaqarr, Tiranë, Shqipëri (në vijim “Blerësi”),

Në vijim Shitësi dhe Blerësi bashkërisht do të quhen “Palët” dhe veçmas “Pala”.

PARASHTRIME

MEQENËSE:

- (a) “FUTBOLL CLUB DINAMO CITY” Sh.A. (“Shoqëria”) është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numrin unik të identifikimit NUIS - M12121037S, me seli në adresën Rruga “Asti Gogoli” Lagjia nr.14, Pasuria me nr.5/104, Vol.9, faqe 214, ZK.8516, Durrës, Shqipëri;
- (b) Siç rezulton nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit bashkëlidhur si pjesë përbërëse e kësaj Kontrate, kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 73.500.000,00 (shtatëdhjetë e tre milion e pesëqind mijë) Lekë, dhe zotërohet 70% nga aksionari i Adrian Bardhi (Shitësi) dhe 30% nga aksionari Ergys Agasi;
- (c) Shitësi dhe Blerësi kanë rënë dakord që Shitësi t'i shesë Blerësit 30% të aksioneve të shoqërisë nga pjesa e pjesëmarrjes së tij në Shoqërisë, që përfaqëson 70% të kapitalit të saj, e cila pas kësaj shitjeje, kalon në vlerën 40%;
- (d) Më datë 23.04.2024 Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë ka vendosur të miratojë transferimin e 30% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi, në favor të Blerësit.

ATËHERË, duke patur parasysh sa më sipër Palët lidhin këtë kontratë sipas kushteve vijuese:

NENI 1 – PARASHTRIMET DHE ANEKSET

- 1.1 Parashtrimet e mësipërme dhe shtojcat e dokumentet bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

NENI 2 – OBJEKTI

- 2.1 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi i shet Blerësit, dhe Blerësi blen nga Shitësi titullin ligjor të 30% të aksioneve të Shoqërisë, nga pjesa e tij takuese, e cila përfaqëson 70% të kapitalit të Shoqërisë;
- 2.2 Aksionet e shitura i korrespondojnë një numri aksionesh prej 1.050 aksionesh, me të drejtë vote, secili me vlerë nominale 21.000 lekë, me një vlerë totale prej 22,050,000.00 (njëzet e dy milion e pesëdhjetë mijë) Lekë.

NENI 3 – KALIMI I PRONËSISË

- 3.1 Kalimi i titullit të pronësisë mbi pjesëmarrjen objekt të kësaj Kontratë, nga Shitësi tek Blerësi do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 4 – ÇMIMI I SHITJES

- 4.1 Si kundërshtëpërblim për shitjen dhe kalimin e pronësisë mbi aksionet objekt të kësaj Kontratë sipas nenit 2.1, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një çmim të barabartë me 22,050,000.00 (njëzet e dy milion e pesëdhjetë mijë) Lekë (në vijim “**Çmimi i Shitjes**”).
- 4.2 Çmimi i Shitjes do të paguhet nga Blerësi, jo më vonë se 10 ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, në llogarinë bankare të komunikuar nga Shitësi.

NENI 5 – DEKLARIMET DHE GARANCITË

- 5.1 Deklarimet dhe Garancitë e Shitësit

Shitësi i deklaron dhe garanton Blerësin se:

- (a) Shitësi është pronar i vetëm i ligjshëm i aksioneve të shitura dhe pjesëmarrjes objekt i kësaj Kontrate, e cila përfaqëson përpara shitjes, 70% të kapitalit të Shoqërisë.
- (b) Shitësi garanton se të gjitha aksionet e Shoqërisë si dhe aksionet e shitura objekt i kësaj Kontrate, të cilat përfaqësojnë 30% të kapitalit të Shoqërisë, janë të lira nga çdo kufizim, barrë siguruuese, peng, garanci pagese, barrë mbi interesat, opion, e drejte parablerje, pretendim, detyrim vote apo marrëveshje tjetër në lidhje me votat, opion blerje apo detyrime, pretendime apo angazhime ndaj të tretëve e kufizime të tjera të çdo lloji;
- (c) Nënshkrimi i kësaj Kontrate dhe plotësimi nga Shitësi i kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate, nuk janë në kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite të: (i) Aktit të Themelimit ose të Statutit, ose të rregulloreve apo vendimeve të tjera të Shitësit, ose Shoqërisë, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, dekreti, ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo të huaj subjekt i te cilit janë Shitësi apo Shoqëria, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi në të cilin Shitësi apo Shoqëria është pale, që do të cenonte aftësinë e Shitësit për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (d) Shitësi ka marrë të gjitha vendimet dhe hapat e nevojshme, si dhe ka autoritet të plotë, për marrjen e çdo vendimi apo miratimi paraprak që mund të kërkohet nga ligji dhe/ose dokumentet e shoqërisë, nëse ka, për të nënshkruar dhe zbatuar këtë Kontratë, dhe se kjo kontratë përmban kushte të detyrueshme për Shitësin.

- (e) Shitësi deklaron se meqenëse Aksionari tjetër dakordëson, në këtë rast nuk do të jetë e nevojshme kryerja e procedurave statutore në lidhje me të drejtën e parablerjes së aksioneve dhe garanton se transferimi i aksioneve tek Blerësi nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi statutor apo ligjor, dhe se kalimi i tyre do të kryhet rregullisht, menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.
- (f) Të gjitha aksionet e Shoqërisë kanë të njëjtat të drejta, të plota dhe përbëjnë aksione të së njëjtës kategori, aksione të zakonshme e me të drejtë vote përpjesëtimisht me vlerën e kapitalit.
- (g) Shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj të tretëve, me përjashtim të detyrimeve të pasqyruara në llogaritë kontabël të shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar ndaj personave që janë në marrëdhënie punësimi apo kontraktore me Shoqërinë dhe në çdo rast Shitësi merr përsipër të përballojë i vetëm, pa cenuar Blerësin, çdo dëm, humbje, detyrim, pasojë financiare si rrjedhojë e pretendimeve të tretëve ndaj Shoqërisë, të lindura deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

5.2 Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

Blerësi i deklaron dhe garanton Shitësin se:

- (a) Blerësi ka të drejtë dhe autoritet të plotë, dhe ka marrë çdo miratim paraprak që mund të kërkohet nga ligji dhe/ose dokumentet e shoqërisë, nëse ka, për të nënshkruar dhe zbatuar këtë Kontratë, dhe se kjo kontratë përmban kushte të detyrueshme për Blerësin.
- (b) Blerësi nuk është në paaftësi paguese, dhe se Blerësi ka në dispozicion likuiditete të mjaftueshme për të paguar plotësisht Çmimin e Shitjes sipas kushteve të kësaj Kontrate.

NENI 6 - TË NDRYSHME

- 6.1 Kjo Kontratë përfaqëson marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj, dhe shfuqizon dhe zëvendëson çdo marrëveshje, komunikim dhe garanci të mëparshme, verbale apo me shkrim, ndërmjet Palëve.
- 6.2 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet rregullisht nga Palët. Brenda afateve të parashkrimit, asnjë vonesë e njëres palë në kërkimin e përmbushjes së detyrimeve kontrakturë të palës tjetër, nuk do të quhet si heqje dorë nga kjo e drejtë, përveçse kur heqja dorë bëhet me shkrim.
- 6.3 Kjo Kontratë rregullohet në bazë të legjislacionit shqiptar. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje këtë Kontrate do të zgjidhet në mirëkuptim mes palëve, përndryshe, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.
- 6.4 Kjo Kontratë hartohet në 3 (tre) kopje identike me të njëjtën fuqi ligjore, në gjuhën shqipe.

SHITËSI

Z. Adrian Bardhi



BLERËSI

FORTIS BETON CO.sh.p.k


